



DREJTORIA E TË ARDHURAVE PUBLIKE DHE ENTI SHTETËROR PËR REVIZION NË NJË VIZITË PUNE NË REPUBLIKËN E ARMENISË

Drejtoresha e Drejtorisë së të Ardhurave Publike, Sanja Lukarevska, dhe Kryerevizori i Shtetrorë Maksim Acevski, së bashku me punonjës nga të dyja institucionet, nga data 18 deri më 20 shtator, realizuan një vizitë pune në Republikën e Armenisë, ku u takuan me përfaqësues të rangut të lartë nga Kuvendi Kombëtar, Ministria e Financave, Komiteti Shtetëror i të Ardhurave dhe Kontrolli Shtetëror i Republikës së Armenisë. Vizita e punës u organizua nga UNDP në RMV. Me Natia Natsvlshvili, përfaqësuese e përhershme e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Armeni, u diskutua për mjedisin institucional në auditimin dhe të ardhurat publike, digjitalizimin dhe mënyrën se si bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i përvojave mund të kontribuojnë në forcimin e institucioneve.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit Kombëtar të Armenisë, Davit Arakelyan dhe Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Çështjet Financiare-Kreditore dhe Buxhetore, Gevorg Papoyan, e njohën delegacionin me mënyrën dhe punën e Kuvendit dhe Komisionit dhe shprehën kënaqësinë e tyre me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, i cili mundëson realizimin e vizitave të tilla të punës për shkëmbimin e përvojave në mënyrë që të forcohen institucionet për t'u bërë organe më efikase dhe më autonome. Drejtoresha Lukarevska theksoi se takimet dhe bashkëpunimet e tilla janë jashtëzakonisht të rëndësishme për forcimin e kapaciteteve të administratës tatimore dhe strukturës institucionale, me të cilat institucionet në RSM bëhen më efektive, më të përgatitura për të përmbushur në mënyrë adekuate përgjegjësitë e tyre.

Biseda produktive u zhvilluan edhe me ekipin e laboratorit kombëtar të inovacionit të UNDP-së, ku u prezantuan zgjidhje të ndryshme inovative, të cilat po i zbatojnë në bashkëpunim me institucionet në Armeni, veçanërisht në fushën e pajtueshmërisë me taksat. Në kuadër të vizitës, drejtori i Entit Shtetëror për revizion, Atom Janyugazayan, prezantoi punën e revizionit dhe mënyrën se si kryhen revizionet në Armeni, ndërsa Lukarevska dhe zëvendësdrejtori i Komitetit të të ardhurave shtetërore të Armenisë, Ashot Muradyan, ndanë përvoja dhe praktikat më të mira të cilat implementohen të dyja administratat tatimore.

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe bashkëpunëtorët afatgjatë të UNDP-së vazhdon dhe do të thellohet në të ardhmen për të ndërtuar një administratë tatimore moderne që ndjek trendet në sferën tatimore.